



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"  
REKTORATI

Nr. 944/11 Prot.

Gjirokastrër, më 31/08/2022

**Lënda:** Hapet thirrja për pjesëmarrje në Programin Erasmus+ me Universitetin e Perugia-s.

Në kuadër të Programit Erasmus+, Universiteti i Perugia-s ka fituar një grant për kërkim shkencor dhe trajnim në bashkëpunim me Universitetin e Gjirokastrës.

Sipas Marrëveshjes kërkohet që Universiteti i Gjirokastrës të marrë pjesë me:  
**2 pozicione** për studentë të ciklit të parë ose të dytë (Bachelor/Master), të cilët do të angazhohen në mësimnxënie për një periudhë 5-mujore në Universitetin e Perugia-s.

Aktivitetit mësimor do të zhvillohet gjatë vitit akademik **2022-2023**, semestri i dytë. Gjuha e përdorur do të jetë anglisht në nivelin B1. Sipas marrëveshjes me Universitetin e Perugia-s, aplikimet janë të hapura për Departamentin e Gjuhëve të huaja (Gjuhë Italiane). Nëse jeni të interesuar, lutemi të dërgoni pranë Sektorit të Marrëdhënieve me Jashtë dhe Kërkimit Shkencor, brenda datës **07.09.2022**:

Për studentët:

- një letër interesi, në shqip dhe anglisht.
- një CV të detajuar mundësisht në formatin EUROPASS CV në shqip dhe në anglisht.
- një provë / çertifikatë të njohurive të gjuhës angleze sipas niveleve të specifikuar më sipër.

Dokumentacioni juaj do të vlerësohet paraprakisht nga një komision AD HOC i ngritur pranë UGJ dhe më pas ky vlerësim do t'i përcillet Universitetit të Perugia-s, për vlerësimin përfundimtar të aplikantëve të cilët do të përzgjidhen.

Prof. dr. Bektash Mema

REKTOR

